

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Elektropompa KUZ”

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-48581-05-21-2025

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Pompa të ujërave të zeza-42122220-8**

VLERA E FONDIT LIMIT: 15 813 600 (pesëmbëdhjetë milion e tetëqind e trembëdhjetëmijë e gjashtëqind) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Lezhë sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar VKM Nr.498 date 1.8.2024 : citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë

paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë me një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, paragrafi c), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (të vitit 2025) sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin. (Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" të ndryshuar, ku përcaktohet: "*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) gjendjen ekonomike dhe financiare; ...3.* Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 "*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare*" të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*" të ndryshuar VKM Nr.498 datë 1.8.2024, **paragrafi 1 dhe 2 germa "b"**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: "*Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat"; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 "*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet**

formës elektronike”. Ne keto kushte, vleresojme të kërkojme kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

U përcaktuan kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Certifikate ISO 9001:2015, “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).

b) Certifikate ISO 14001:2015, “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

2.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se

operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuethshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK do të paraqesë certifikatën origjinale të origjinës së mallrave ose fotokopje të noterizuar të saj.

2.8. Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , web-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi I produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

-Emri, Adresa dhe ëbsite i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-Referenca në katalogje, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr,i faqes)duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1, si dhe njoftimit të APP-së nr.prot 7459/4, datë 25.05.2021.

2.9 Operoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin flete garanci me afat 12 muaj per mallrat objekt te ketij tenderimi, duke filluar nga data e furnizimi/montimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi garancia e mallrave jep siguri per furnizime cilesore dhe e ben operatorin ekonomik fitues me te pergjegjshem per produktet qe oferton.

2.10 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Deklaratë që merr përsipër transportin dhe lëvrimin e mallrave drejt ambjenteve magazinuese/stacioneve te pompimit të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi mjeti i transportit nevojitet per transportin e mallrave objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

3.Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të paraqitura më poshtë janë për el/pompa zhytëse për ujë të zeza të shoqëruara me panele lëshimi me ndryshues frekuence (Drjavera) të cilat duhet të jenë të reja dhe të prodhuara sipas normave ISO, IEC, EN në Europë, USA, Japoni që janë prodhime perparetore por janë të pranueshme dhe elektropompa dhe panelet e lëshimit të tyre të prodhuara nga vendet e tjera me kusht që të jenë të barasvlerëshme me specifikimet teknike dhe plotësimin e standarteve të mësipërme.

I.Fusha e përdorimit.

Elektropompat zhytëse për ujë të zeza do të përdoren për të transportuar ujë të ndotura nga pusët dhe kanalizimeve, impiantet e trajtimit të ujërave dhe përdorime të tjera të ngjashme. Më poshtë po japim specifikimet teknike të elektropompave të ujërave të zeza sipas objekteve ku ato do të përdoren pasi elektropompat ekzistuese pothuajse janë amortizuar nga përdorimi i tyre në ambient agresiv dhe të konsumuara nga koha e gjatë e përdorimit të tyre për më tepër se 20 vite.

II.Objektet për të cilat do të blihen elektropompa dhe sasia e tyre për çdo objekt.

Elektropompat e ujërave të zeza të shoqëruara me panelet e lëshimit do të prokurohen si Blerje Mallarash por është mirë që operatori ekonomik ose bashkimi i operatorëve të vizitojë objektet ku do të vendosen ato me qëllim që të mos të ketë probleme për instalimin e tyre në të ardhmen.

Keto objekte janë :

- | | |
|--|--------|
| • Stacioni pompave të ujërave të zeza Kune | cope 2 |
| • Stacioni pompave të ujërave të zeza Shengjin Qender | cope 3 |
| • Impjanti perpunimit të ujërave të zeza | cope 2 |
| • Stacioni pompave të ujërave të zeza transmetues Ishulli Shengjin | cope 2 |

TOTALI COPE 9

Të gjitha elektropompat janë të njëjta dhe duhet të shoqërohen me bazamentet e fiksimit në shtresën e betonit të pusët të stacionit të pompimit të dhëna në figurën orientuese më poshtë.

Elektropompa duhet të shoqërohen me panelet e lëshimit që sipas mundësisë që të lejojnë hapësirat në objekte mund të jenë çdo elektropompë një panel lëshimi elektrik pra për 9 elektropompa 9 panele lëshimi ose 4 panele lëshimi për të katër objektet 3 panele për lëshim për 2 elektropompa dhe 1 panel për lëshim me 1 elektropompë. Panelet duhet të jenë të pajisura me **NDRYSHES FREKUENCE** (DRAJVERA) me fuqi më të madhe se 30% e fuqisë së elektromotorit të pompës. Përdorimi i paneleve të lëshimit me ndryshues frekuence (Drajver) lejon rregullimin e pikes së punës duke të dhënë mundësinë e përdorimit të një elektropompe për të gjithë objektet gjë që sjell përfitime ekonomike nga ulja e kostos së mirëmbajtjes gjatë përdorimit të tyre.

Për hollësi shikoni specifikimet teknike të paneleve të lëshimit për elektropompat

III.Elektropompa për ujë të zeza cope 9

Keto elektropompa do të përdoren për funksionim të ndërprerë dhe të vazhdueshëm në instalime të zhytura. Rrota e punës duhet të jetë me një kanal që përpunon mbetjet të kanalizimeve të ujërave të zeza deri në 100 mm.

Sistemi i rregullimit të hapësirës së rrotes së punës **SmartTrim** bën të mundur ruajtjen e karaktersistikave maksimale gjatë jetëgjatësisë së pompës.

Për të lehtësuar transportin dhe instalimin në terren, pompa është e pajisur me element ngrites të te pershteteshem . Për instalim është e pajisur me menyre vete bashkuese, sistemi i mbylljes **Smart Seal** siguron një lidhje të papërshkueshme nga uji. Lidhjet e tubacioneve janë përmes një flanaxhe DIN si ne vizatimet e dhena me poshte per elektropompen zhytëse per ujra te zeza.

Te dhenat teknike te elektropompave jane si me poshte:

Jane te pajisur me dhensa kontrolli per:

- **Lagështine:** Me dhensa lagështie

Te dhena per mjedisin qe punon

- **Ujra me kufij te temperaturës :** 0 .. 40 °C
- **Temperatura e punes se ujit:** 20 °C
- **Dendësia:** 998.2 kg/m³

Të dhëna teknike

- **Prurja maksimale: 124 l/s**
- Diametri aktual i rrotes së punes: 314 mm
- Lloji i rrotes së punes: 1-KANAL
- Maksimumi i madhësisë së mbetjeve të ngurta: 100 mm
- Toleranca e kurbës: ISO9906:2012 3B
- Klasa e lartësisë së ngritjes: M

Konstruksioni.

- Trupi i pompës: Gize
 - EN 1561 EN-GJL-250
 - A48 30
- Rrota e punes: Gize
 - EN 1561 EN-GJL-250
 - ASTM A48-30
- Motori: Gize
 - EN 1561 EN-GJL-250
 - A48 30
- Permistopi i boshtit: SIC
- Permistopi dytesor i boshtit: SIC-KARBON

Instalimi

- Kufijt e temperaturës së ambientit: 0 .. 40 °C
- Lloji i dimensionit: DIN
- Dimensioni i daljes: DN 125
- Presioni nominal : PN 10

- Thellësia maksimale e instalimit: 20 m
- Vetebashkim


Të dhënat elektrike




- Madhësia e karkases: 62
- Fuqia qe merr nga rrjeti P1: 34 kW
- **Fuqia ne bosht P2: 30 kW**
- Frekuenca e rrjetit: 50 Hz
- Tensioni i rrjetit: 3 x 400 V
- Toleranca e tensionit: +10/-10 %
- Maksimumi i nisjeve për orë: 15
- Rryma e nominale: 67/39 A
- Rryma maksimale: 67 A
- Rryma e nisjes: 460 A
- Rryma e punimit pa ngarkese: 39.6 A
- Shpejtësia nominale: 1482 rpm
- Rendimenti i motorit në ngarkesë të plotë: 89 %
- Rendimenti i motorit në 3/4 ngarkesë: 87 %
- Rendimenti i motorit në 1/2 ngarkesë: 84 %
- Numri i poleve: 4
- Menyra e nisjes: Y/D
- Klasa e mbrojtjes (IEC 34-5): IP68
- Klasa e izolimit (IEC 85): F
- Antieksplziv: Jo
- Standardi i mbrojtjes nga shpërthimi: N
- Mbrojtja e motorit: KLIXON
- Tipi i kabllit të furnizimit me energji elektrike: H07RN-F AT
- Gjatësia e kabllit të furnizimit me energji elektrike: 10 m
- Rezistenca e mbështjelljes: 0.167 Ohm
- Faktori i fuqisë 1/1: 0.73
- Faktori i fuqisë 1/2: 0.52
- Faktori i fuqisë 3/4: 0.64

Të tjera

- Pesha neto: 600 kg
- Pesha bruto: 710 kg
- Vendi i origjinës: Hungari (HU)

Pamja e jashteme dhe menyra e instalimit dhe bazamenti elektropompes.





IV. Panele leshim me ndryshues frekuence (Drajver)

1. TE PERGJITHESHME.

PLPNF(Panel leshimi elktropompe me ndryshes frekuence) duhet te jete projektuar duke patur parasysh normat dhe standartet Shqiptare dhe Nderkombetare.

PLPNF sherben per Leshimin e elektropompave siperfaqesore dhe zhytese sipas menyres se leshimit :

Leshim direkt ne rrjetin 3x380V+N,50Hz me NDRYSHES FREKUENCE(DRAJVER)

Paneli i leshimit te elektropompeve zhytese do te kete si skeme baze elektrike leshimin e cdo elktropompe ne menyre te vecante pra 9 elektropompa do te kene 9 skema leshimi sipas kerkesave te mesiperme por keto skema sipas hapsires qe te lejon stacioni mund te grupohen me 3+2+2+2 me kater grupe panele leshimi per 9 elektropompat ose me 9 panele leshimi te vecanta per 9 elektropompat..


PLPNF zgjidhet sipas fuqise se propozuar te elektropompave dhe perbehet nga :

- Dollap metalik me shkalle mbrojtje IP 54 sipas madhesise se skemes qe jep prodhuesi.
- Sistemi i zbarrave te energjise elektrike
- Celes automat 3P ose Celes thike sigures
- Ndryshes frekuence (Drajver) me fuqi me te madhe se 30% e fuqise se elktromotorit te pompes zhytese.
- Lexues elektronik i drajverit me ekran, butona per konfigurimin e tij
- Kanalina PVC per shperndarje e kabllave
- Kabllo elektrik te TU te fuqise
- Perciellesit e komandim sinjalizimit
- Morseteri
- Buton leshimi ndalimi dhe avarie.
- Dalje per nevojat vetjake te stacionit te pompave.


2. SKEMA ELEKTRIKE ORJENTUESE.

Perbehet nga :

A.Skema e fuqise



B. Skema e komandimit dhe e mbrojtjes



C.Pamja e jashteme

00	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
A	B	C	D	E	F	G						
A	B	C	D	E	F	G	POROSITES:SHRUK LEZHE OBJEKTI: PANEL LESHIM MOTORI 3x30kW,LESHIM DIREKT NE RRJETIN 3X380V,50Hz,ME NDRYSHES FREKUENCE					
EMERTIMI I FLETES : PAMJA E PANELIT TE LESHIMIT SHEKILLA ☐ : ☐							Projektor Kontrollor Approvot		FLETA NR. E-02 INDEX FLETA E-X-X VITI 2025			
H	00 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12											

D.Pershkrimi i skemes elektrike model per nje,dy ose tre leshime elektropompash.

Skema elektrike e fuqise paraqet:

- Hyrje transformatori ose burimi i furnizimit me energji elektrike 3x380V+N,50Hz.
- Celsin automat ose celsin thike sigures te hyrjes se fuqise per leshimin e elektropompe.
- Ndryshesin e frekuences(Drajverin) per leshimin e elektropompe
- Celsa sigures per qarkun e komandimit te NF dhe nevojave vetjake te stacionit te elektropompave.
- Ofertuesi duhet te paraqese ne oferte tip[in e ndryshuesit te frekuences (Drajverit) qe do te permbajene panelet e leshimit te elektropompave zhytese te ujrave te zeza dhe propozimin zgjidhjen ne grup ose te vecanta te paneleve te leshimit te elektropompave.
- Ndryshuesi i frekuences duhet te kete pervec ndryshimit te frekuences si karakakteristike kryesore por edhe karakteristika te tjera specifike si :

a.Mbrojtjen nga:

- Mbingarkesa e rrymes.
- Ndryshimet e tensionit.
- Ndryshimi fazeve te rrjetit.
- Asimetria e fazeve.
- Mbrojtjen nga temperature.
- Mbrojtjen nga prishja e izolimit.
- Punimi ne te thate i elektropompe (kur eshte zhytese).

b.Matje te :

- Rrymes.
- Tensionit.

c.Sinjalizim.

- Llampa jeshile tregon qe elektropompa eshte ne funksionim.
- Llampa kuqe tregon qe pompa eshte jashte funksionimit.
- Llampa verdhe tregon qe ka vepruar nje nga mbrojtjet e elektropompe.

V.Dokumenta shoqerues.

Panelet e leshimit duhet te shoqerohen me :

- Skeme elektrike fuqie
- Skeme elektrike komandimi
- Listen e materjaleve marka dhe origjina e elementeve te skemes elektrike
- Udhezuesin e perdorimit

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga specialistet e fushës.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente.

